

VENDIM
Nr. 64, datë 6.9.2018

**PËR MOSMARRJEN NË SHQYRTIM TË APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E TARIFAVE
TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR
SHOQËRINË UJËSJELLËS-KANALIZIME FIER**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 21, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 39, datë 9.12.2015, “Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura”; të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimin e ujërave të ndotura”, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi aplikimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Fier, për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, Komisioni Kombëtar Rregullator,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Fier është licencuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, me vendimin nr. 2, datë 22.1.2014, “Për licencimin e Ujësjiellës-Kanalizime Fier”, me afat vlefshmërie deri në datën 21.1.2018.

- Shoqëria UK Fier, me shkresën nr. 122 prot., datë 31.1.2018, ka aplikuar për rinovimin e licencës, si dhe për zgjerimin e zonës së shërbimit në kuadër të riorganizimit, sipas ndarjes së re territoriale. Në dokumentacionin e dërguar pranë ERRU-së mungon dokumenti “Akt miratimi i lejes higjieno-sanitare”, dokument i cili ende nuk është paraqitur nga shoqëria.

- Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e mëparshme, ka gjykuar që shoqëria UK Fier duhet të plotësojë dokumentin e mësipërm me qëllim vijimin e procedurës për licencimin e saj.

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Fier, me shkresë nr. 752 prot., datë 23.10.2017, ka aplikuar për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, për zonën e re të shërbimit që ka marrë në administrim.

- Dosja e aplikimit, për miratimin e tarifave të reja të propozuara nga shoqëria UK Fier, është paraqitur e plotë sipas standardit të kërkuar nga ERRU-ja për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm.

- Për shqyrtimin e analizës, si dhe vendimmarrjen për tarifën e propozuar nga UK Fier, pengesë mbetet mungesa e rinovimit të licencës së shoqërisë UK Fier edhe për zonën e re të shërbimit.

- Në mbledhjen e datës 6.9.2018, Komisioni Kombëtar Rregullator analizoi dhe një herë situatën e aplikimeve për ndryshimin e tarifave të shoqërive UK. Për shoqërinë UK Fier gjykoj se ka kaluar një periudhë e gjatë që nga momenti i aplikimit, ku shoqëria UK Fier nuk është treguar korrekte me plotësimin e dokumentacionit të kërkuar, me qëllim vijimin e procedurës nga ERRU-ja, për pajisjen me licencë për shërbimet UK, e cila ka frenuar procedurën e mëtejshme të aplikimit për miratimin e tarifave.

Për sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të mos marrë në shqyrtim aplikimin e Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Fier për miratimin e tarifave

të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për zonat e reja.

2. Shoqëria Ujësjetës-Kanalizime Fier detyrohet të aplikojë për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura, me dokumentacionin dhe të dhënat e plota, pasi licenca për ushtrimin e aktivitetit të jetë miratuar nga KKRR-ja.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani